

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Zhvillimi i linjave TM 20kV, kabinave elektrike dhe linjat TU me përcjellës ABC, për fiderat O1 dhe O2 nga N/Stacioni Orikum 110/35/20kV për furnizimin me energji elektrike të zonës Radhimë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45231400-9 Puna e ndertimit për linjat e energjise elektrike.

VLERA E FONDIT LIMIT:

456,855,685.16 leke (katërqindë e pesëdhjetë e gjashtë milione e tetëqinde e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqindë e tetëdhjetë e pesë pike gjashtëmbëdhjetë)Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 450,000,000 (katerqind e pesëdhjete milion) Leke.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mesiperme eshte ne perpjestim dhe e lidhur ngusht me objektin e kontrates. Duke marre ne konsiderate sasine e mallrave dhe punimet objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomiko - financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlera e xhiros duhet te jete ne masen 450,000,000 (katerqind e pesëdhjete milion) Leke.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet të ketë realizuar të paktën:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 225,000,000 (dyqind e njëzet e pesë milion) Lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se 900,000,000 (nëntëqind milion) Lekë.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe aktin përfundimtar të kolaudimit që dëshmojnë përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, sipas parashikimeve të nenit 88, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kushti i përcaktuar më sipër në lidhje me kontratat e ngjashme plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën baze ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave objekt prokurimi, si dhe punimet e kerkuara, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete sipas parashikimeve ligjore. Ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

Gjithashtu eshte percaktuar lloji i kontratave te ngjashme, te cilat ne menyre te pergjithshme duhet te kene ngjashmeri me objektin e procedures se prokurimit.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licence profesionale, ne fushen e zbatimit te punimeve, leshuar nga organet kompetente, e cilat te permbajne kategorite e meposhtme:*

<i>Kategoria NP-1</i>	<i>Punime germimi ne toke</i>	<i>Klasifikim A</i>
<i>Kategoria NP-11</i>	<i>Ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise</i>	<i>Klasifikimi E</i>

Shenim : *Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.*

Argumentimi: Keto kategori punimi janë në përputhje me zërat e preventivit paraprak dhe objektin e prokurimit, janë proporcionale dhe te lidhura ngusht me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë lidhur me licencën profesionale të shoqërisë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/a, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht punonjesit si me poshte vijon:*

- *Si drejtues teknik te perfshire ne licencen e shoqerise te pakten 1 (nje) inxhinier elektrik.*
- *Gjithashtu si pjese e stafit te tij ofertuesi pervec inxhinierit te mesiperm duhet te kete dhe 1 (nje) inxhinier elektrik, 1 (nje) inxhinier gjeoded dhe 1 (nje) inxhinier ndertimi.*

Inxhinieret e mesiperm duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: kontratat individuale te punes, shoqeruar me diplomat perkatese te inxhinierëve te mesiperm, si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për inxhinieriët e sipërcituar është në përpjestim dhe e lidhur me objektin e kontratës, respekton edhe parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë minimale e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e vet tregëtar keto lloj niveli punimesh. Keto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me pikën 6, të Nenit 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë me shkrim se inxhinieret e pershkruar në pikën 2.3.3 për kualifikim janë të pa angazhuar në kontrata të tjera dhe, në rast se shpallen fitues për këtë procedurë, do të qendrojnë në objekt gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve.*

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur me qëllim për garantimin se OE ofertues do të realizojë kontratën objekt procedure prokurimi me prioritet dhe pa vonesa. Realizimi i kësaj kontrate do të bëhet në përputhje me normat e sigurisë së Autoritetit Kontraktor, me stakime të nevojshme të koordinuara dhe për këtë qëllim duhet që OE ofertues ta realizojë atë me angazhim të plotë të stafit të tij.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka fuqinë punëtore të nevojshme minimalisht 90 (nëntëdhjetë) punonjës me kohë të plotë pune, për ekzekutimin e objektit të prokurimit, Punonjësit duhet të jenë të siguruar të pakten për 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.*

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë listpagesat E-Sig të punonjesve të sipërcituar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me numrin e fuqisë mesatare punëtore të siguar, duke patur parasysh volumet e punëve objekt kontrate, natyrën dhe vlerën e kontratës, ky numër punonjësish është proporcional dhe i lidhur me aftësinë zbatuese, me qëllim realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës. Numri i punonjesve është përlogaritur duke patur në konsideratë shtrirjen gjeografike të linjes objekt punimi, si dhe volumin e punës për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/ç, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë minimumi 36 (tridhjetë gjashtë) punonjes, të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të leshuar nga shoqëri të akredituara në bazë të ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar, si më poshtë*
Kategoria V – 1 (nje) Inxhinier Elektrik
Kategoria IV – 3 (tre) Punonjes
Kategoria III – 7 (Shtate) Punonjes
Kategoria II dhe I – 25 (njetzet e pese) Punonjes

Lidhur me këto pike operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:

- i) listpagesat E-Sig të punonjesve të sipercituar si dhe*
- ii) kartelat perkatese të vlefshme të sigurimit teknik.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për personelin e pajisur me kartelat e sigurimit teknik, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë kartelat perkatese të punonjësve që do të kryejnë punimet objekt kontrate. Një numer i tillë të siguruarish është kërkuar pasi punimet objekt procedure prokurimi kërkojnë punonjës të kualifikuar dhe të aftë, që të punojnë sipas kërkesave të sigurisë në punë për të shmangur rrezikun për jetën, shëndetin dhe çdo problem tjetër, gjatë zbatimit të kontratës.

Punonjesit që do të realizojnë këto kontrate, për arsye të natyrës teknike të saj dhe kushteve të punës në linjat e tensionit të lartë, duhet të respektojnë rregulloren e sigurimit teknik elektrik, bazuar në dispozitat ligjore perkatese për punimet mbi 1000 Volt, në lartësi, me heqje dhe pa heqje tensioni.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues duhet të kenë në stafin e Tij, 1 (një) punonjes që të disponojë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në*

përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" i ndryshuar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Persa i perket kerkeses per nje punonjes te trajnuar dhe te pajisur me certificate si pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune, argumentohet se eshte i nevojshem te qendroje ne kantierin e punimeve per te ndjekur ecurine e punes se punonjesve te OE ofertues dhe te jete i gatshem ne rastin e paraqitje se kushteve te rrezikshme qe mund te ndodhin gjate zbatimit te kontrates objekt prokurimi, ne perputhje me Ligjin Nr. 10237, date 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i ndryshuar.

Keto kërkesa janë në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe pika 6/c, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.3.8 *Operatori ekonomik ofertues per përmbushjen e kontratës duhet te dëshmoj se ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme, si me poshte vijon:*

Nr.	Mjetet	Sasia
1	Eskavator me goma	2 copë
2	Kamionë veteshkarkues me kapacitet mbajtës 10 -20Ton	5 copë
3	Autovinc me kapacitet mbartes minimal 5 ton	2 copë
4	Autobetoniere kantieri (Mjete Teknologjik) 2.5 m ³ -3 m ³	2 copë
5	Fadroma (mjete teknologjik)	3 copë
6	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	3 copë
7	Automjet vinc kulle per punime ne lartesi	2 copë
8	Kenotron per kablllo, Megaometer 500 V, Megaometer Meger 2500- 5000 V dhe aksesoret e nevojshme per kryerjen e matjeve dhe testeve te aparaturave elektrike)	2 copë
9	Kambaleca per mbajtjen e barabaneve te kablllove	
10	Pajisje terheqese per percjellesat (me dinamometer, Paranga karukla)	3 copë
11	Terrameter per matjen e rezistences se tokezimit	2 copë

12	<i>Kambaleca per ngjitje ne shtylle</i>	<i>20 copë</i>
13	<i>Minifadromë me goma</i>	<i>1 copë</i>
14	<i>Autovinc me kapacitet mbartes minimal 16 ton</i>	<i>1 copë</i>
15	<i>Prerese Asfalti</i>	<i>1 copë</i>
16	<i>Rul me Vibrim</i>	<i>2 cope</i>
17	<i>Rul me Kompresor</i>	<i>2 cope</i>
18	<i>Fshese Asfalti</i>	<i>1 copë</i>
19	<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>1 copë</i>
20	<i>Mjete mbrojtese</i>	
	<i>a. Kokore</i>	<i>30 cope</i>
	<i>b. Fikse Zjarri</i>	<i>5 cope</i>
	<i>c. Tabela Sigurimi Teknik</i>	<i>15 cope</i>
	<i>d. Kuti Ndhime e shpejt</i>	<i>2 cope</i>

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike operatori duhet te disponoje:

- 1. Per mjetet, makinerite dhe pajisjet në pronësi te paraqitet akti i pronësisë (kontrata shitblerje, fatura tatimore e shitjes ose fatura e zhdoganimit etj.)*
- 2. Per mjetet, makinerite dhe pajisjet me qira të paraqitet kontratë qiraje si dhe akti i pronësisë së qiradhënësit sipas percaktimit te bere me lart.*
- 3. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi akt kolaudimi, siguracion, taksat vjetore, leje transporti dhe çertifikaten e pronësisë se mjetit) dhe foto ku te duket qarte targa e mjetit.*
- 4. Makinerite e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë deklaruar në një procedurë tjetër tenderimi në të cilën nuk është shpallur ende fituesi.*
- 5. Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku pranon se Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Mjetet dhe pajisjet teknike te vendosura si kërkesë për tu plotësuar nga OE, janë të domosdoshme për punimet gjate realizimit te kontrates objekt procedure prokurimi, për realizimin e punimeve që do të kryhen. Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pika 6/d, e nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.9 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO, te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:*

- ✓ *ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.*
- ✓ *ISO 14001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.*
- ✓ *ISO 45001: për Sistemin e menaxhimit të sigurise ne pune, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.*
- ✓ *ISO 50001: per menaxhimin e energjise*

Argumentimi: Ne lidhje me kërkesën qe OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me to, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare, të objektit të kontratës.

Certifikata per sistemin e menaxhimit te cilesise ISO 9001: eshte sot referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithë sektoreve dhe te gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ISO 14001: e kerkuar nga AK garanton se OE ofertues eshte i certifikuar per produkte dhe punime te cilat nuk demtojne mjedisin dhe nuk e ndotin ate dhe qe jane konform standardeve nderkombetare te cilesise.

Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001: eshte vendosur si kriter kualifikues per operatoret ekonomik ofertues sepse ka te beje me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila eshte me nje rendesi te vecante per kryerjen e kesaj kontrate. OE ofertues qe do te realizoje kontraten objekt procedure prokurimi duhet te kryeje punimet objekt procedure prokurimi dhe kjo kategori licence minimizon rreziqet qe mund te shfaqen gjate realizimit te kesaj kontrate.

Certifikatë për Sistemin e menaxhimit të Energjisë ISO 50001: është e nevojshme si kriter kualifikues, pasi lidhet me natyrën e kontratës, veprimtarine dhe perdorimin e pajisjeve per te cilat duhet te kete nje siguri qe nuk shperdoroje energjine e nevojshme gjate realizimit te punimeve. Me

ane te ketij certifikimi, identifikohen dhe menaxhohen rreziqet që lidhen me furnizimin e ardhshëm të energjisë, mundesohet matja dhe monitorimi i përdorimit të energjisë për të identifikuar se ku të përmirësohet efikasiteti. Po ashtu do të përmirësohet performanca e përgjithshme për të ulur konsumin e energjisë, etj.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.10 Për listën e mëposhtme të artikujve

- *Kabell XLPE 20kV AL (sipas specifikimeve teknike)*
- *Kabine parafabrikat tip Box (sipas specifikimeve teknike)*
- *Cele TM 20 kV me SF6 (sipas specifikimeve teknike)*
- *Transformator Fuqie (sipas specifikimeve teknike)*
- *Kabell TU me vetmbajtje ABC (sipas specifikimeve teknike)*
- *Kabell koaksial (sipas specifikimeve teknike)*
- *Shtylla B/A (sipas specifikimeve teknike)*
- *Panel TU (sipas specifikimeve teknike)*

operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë për materialet e mësipërme:

Certifikatat e cilesisë, Autorizim nga prodhuesi/distributor, skeden teknike/katalogun e pajisjeve të lartpermendura si dhe test reportet për pajisjet e lartpermendura.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar Urdhërit të Brendshëm të Administratorit të OSSH SH.A “Për energjizimin e rrjetit të Shpërndarjes së energjisë elektrike i cili realizohet nga aplikanti në zbatim të rregullores për lidhjet e reja në sistemin e Shpërndarjes” Nr. 7 datë 23.03.2023 dhe nenit 44 “Kërkesat e cilesisë” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 ku përcaktohet “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

2.3.11 Në funksion të plotësimit të Shtojces 8 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë,

Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar nga OSSH sh.a Qender duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per punimet objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

Njesia prokurimit:

Arjola Danaj

Ninela Jashari

Lulzim Kopaci